



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura III

Sesioni pranveror

Komisioni për Legjislacion dhe Gjyqësi

Mbledhja nr. 13

Prishtinë, më 12 prill 2010, në orën 13:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla C-203

PROCESVERBAL

I mbledhjes së Komisionit për Legjislacion dhe Gjyqësi

Në mbledhje morën pjesë: Bahri Hyseni - kryetar, Bajram Kosumi, Adem Hajdaraj, Ramadan Gashi, Adem Salihaj, Ibrahim Makolli, Armend Zemaj, Kolë Berisha, Radmila Vujoviq dhe Mufera Şinik.

Mungoi: Selville Halimi.

Të ftuar dhe pjesëmarrës të tjerë: Bedri Bahtiri, Shkëlzen Maliqi dhe Ehat Miftaraj – MD, Petrit Hysaj - OSBE, Njomza Berisha Miftari – RTK, Senada Berisha – praktikante – RTK, Lumnije Murati – ZPRK, Isuf Zejna – KDI, Saranda, Albulena Ademi dhe Dafina Bardhi – praktikante.

Nga Stafi i Komisionit: Idriz Tahiri, Fehmi Hyseni, Sulltane Gashi dhe Visar Krasniqi.

Mbledhjen e kryesoi: Bahri Hyseni, kryetar i Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky

Rend i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës,
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së 6 prillit 2010,
3. Shqyrtimi i rekomandimeve të grupit të punës për Raportin e Agjencisë Kundër korrupsionit për vitin 2009,
4. Shqyrtimi i Propozimamendamenteve të grupit të punës dhe të deputetit Riza Smaka, për Kodin e Drejtësisë për të Mitur,
5. Shqyrtimi i kërkesës së Bashkësisë Islame të Kosovës,
6. Shqyrtimi i çështjes përkitazi me raportimin e ministrave dhe udhëheqësve të

institucioneve të tjera të pavarura, para Komisionit dhe përgatitjet për dëgjimin publik me ministrin e Drejtësisë, Këshillin Gjyqësor dhe Prokurorial të Kosovës, lidhur me procedurat e bashkëpunimit ligjor ndërkombëtar,

7. Të ndryshme.

Kryetari konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe hapi mbledhjen me pikën e parë të rendit të ditës

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi ditës u miratua pa ndryshime.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së 6 prillit 2010

Kryetari konstatoi se Komisioni miratoi procesverbalin e mbledhjes së mbajtur më 6 prill 2010, pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i rekomandimeve të grupit të punës për Raportin e Agjencisë Kundër Korrupsionit për vitin 2009

Kryetari - I njoftoi se në mbledhjen e Komisionit ky raport nuk është miratuar, është kërkuar që të formohet grupi punues për t'i nxjerrë disa rekomandime para se të përcillet për shqyrtim dhe për miratim në Kuvend. Ky grup punues më 7 prill ka mbajtur takim, në të cilin e ka shqyrtuar Raportin e Agjencisë Kundër Korrupsionit, me ç'rast ka nxjerrë disa rekomandime që janë prezantuar në këtë mbledhje të Komisionit. Hapi debat nëse ndonjëri nga anëtarët ka për të paraqitur rekomandime të tjera.

Armend Zemaj - U pajtua me rekomandimet e dala nga grupi punues, por ishte i mendimit që t'i shtohet edhe një rekomandim si: *Të shtohet përkrahja financiare për Agjencinë Kundër Korrupsionit.* Kjo ngase ne po kërkojmë ngritjen e kapaciteteve të Agjencisë, gjë që nuk është e mundur pa përkrahjen financiare. Prandaj duhet të kihet parasysh që me rastin e rishikimit të buxhetit Qeveria, Komisioni për Buxhet dhe Financa dhe Kuvendi t'i jepet përkrahje financiare Agjencisë. Shtesat për rrezikshmëri nuk i marrin, që është një përkrahje për punën e tyre dhe për të përmbushur detyrimin ligjor.

Ibrahim Makolli - Theksoi se si mund të jetë efikase dhe e pavarur Agjencia kur buxheti është kaq i kufizuar dhe kur Ministria për Ekonomi dhe Financa vendos se sa do të jetë buxheti i Agjencisë. Shtoi se duhet të shikohet mundësia që këto Agjenci të mos jenë të varura nga ministria, nëse do t'u jepet buxhet ose jo, kjo do të duhej të jetë nën autoritetin e Kuvendit. E përkrahu propozimin e Armend Zemajt, që të shtohet përkrahja financiare për Agjencinë.

Bajram Kosumi - Në fjalën e tij tha se grupi punues ka paraparë disa rekomandime, ndërsa rekomandimi që këtë mbështetje financiare i plotëson këto rekomandime. U pajtua me parafolësit që të shtohet si rekomandim mbështetja financiare, që me rastin e rishikimit të buxhetit, Kuvendi ta rritë mbështetjen financiare të Agjencisë tash dhe në vijueshmëri.

Ishte i mendimit që rekomandimi i tretë: *Të ngrihen kapacitetet profesionale të Agjencisë për ta luftuar korrupsionin*, tha se është pak sa i përgjithësuar. Prandaj do të ishte mirë të ishte pak më i hollësishëm, duke precizuar se në cilat fusha duhet të ngrihen këto kapacitete.

Kryetari konstatoi se Komisioni në mënyrë unanime nxori këtë:

REKOMANDIM

- I. Të shqyrtohet dhe të miratohet nga Kuvendi i Republikës së Kosovës Raporti vjetor i Agjencisë Kundër Korrupsionit për vitin 2009,
- II. Të shtohet efektiviteti i Agjencisë në parandalimin e korrupsionit,
- III. Të ngrihen kapacitetet profesionale të Agjencisë për ta luftuar korrupsionin.
- IV. Të shtohet përkrahja financiare për Agjencinë Kundër Korrupsionit.

4. Shqyrtimi i Propozimamendamenteve të grupit punues dhe të deputetit Riza Smaka, për Kodin e Drejtësisë për të Mitur

Kryetari propozoi që në mungesë të eksperteve të angazhuar nga Komisioni, të cilët nuk janë ftuar, të jenë në mbledhje të Komisionit. Kjo pikë të shtyhet për mbledhjen e radhës.

5. Shqyrtimi i kërkesës së Bashkësisë Islame të Kosovës

Kryetari - I njoftoi me shkresën e Kryesisë së Bashkësisë Islame të Kosovës, me të cilën kërkojnë që të bëhet inkorporimi i lëndës “ Edukata Fetare “ në arsimin fillor dhe të mesëm. Propozoi që në këtë fazë kjo shkresë t’i procedohet Komisionit për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini dhe Sport, sepse ne mund ta japim kontributin në procedurat e mëtejme.

Ibrahim Makolli - Kërkoj sqarim se a i është drejtuar Komisionit apo secilit deputet, sepse e njëjta shkresë ju është drejtuar të gjithë deputetëve? Theksoi se kërkesa nuk ka ardhur në emër të Komisionit dhe nuk është kërkuar të shqyrtohet, por ka ardhur për secilin deputet me emër dhe mbiemër.

Adem Hajdaraj - Duke u ndërlidhur me parafolesit theksoi se me këtë shkresë kërkohet që Komisioni të japë mendimin se a është e ligjshme kjo kërkesë, ndërsa ishte i mendimit që për procedim të mëtejme t’i dërgohet Komisioni për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini dhe Sport.

Bajram Kosumi - Theksoi se Komisioni në këtë fazë nuk do të duhej ta shqyrtojë para se Kryesia e Kuvendit ta japë qëndrimin e saj. Ishte i mendimit që vetëm pasi të shqyrtohet nga Kryesia, ne mund ta japim kontributin tonë.

Kryetari konstatoi se Komisioni në mënyrë unanime nxori këtë:

P e r f u n d i m

Komisioni nuk do ta shqyrtojë kërkesën e Kryesisë së Bashkësisë Islame deri në marrjen e një qëndrimi nga Kryesia e Kuvendit të Republikës së Kosovës.

6. Shqyrtimi i çështjes përkitazi me raportimin e ministrave dhe udhëheqësve të institucioneve të tjera të pavarura para Komisionit dhe përgatitjet për dëgjimin publik me Ministrinë e Drejtësisë, Këshillin Gjyqësor dhe Prokurorial të

Kosovës lidhur me procedurat e bashkëpunimit ligjor ndërkombëtar

Kryetari - Theksoi se me Planin e veprimit është paraparë që Komisioni në muajin prill të mbajë një dëgjim publik, ku do të ftojë ministrin e Drejtësisë, Këshillin Gjyqësor dhe Prokurorial të Kosovës dhe Institutin Gjyqësor të Kosovës. Kërkoj nga anëtarët të deklarojnë se a duhet të ftohen edhe Agjencitë në këtë takim ose ta kemi një takim të veçantë me përfaqësuesit e Ministrisë së Drejtësisë, Këshillin Gjyqësor dhe Prokurorial të Kosovës dhe Institutin Gjyqësor të Kosovës.

Bajram Kosumi - Ishte i mendimit që duhet të caktohet tema që do të debatohet në takimet me secilin nga këto institucione në takime të veçanta. Nuk përjashtimet mundësia që me ndonjë nga institucionet të mbajmë takim të përbashkët, varësisht cila do të jetë tema që do të diskutohet. Kërkoj që të bëhet sqarimi se a do të jenë dëgjime publike ose do të ftohen të raportojnë.

Ibrahim Makolli - U pajtua me parafolësin se duhet të sqarohet se a do të jenë dëgjime publike ose raportime. Sepse me Rregulloren e punës ministritë raportojnë për punën e tyre, së paku një herë në vit, para Komisionit. Shtoi se është viti i tretë që asnjë nga ministritë nuk kanë raportuar për punën e tyre. Kërkoj që të precizohen se a ftohen të raportojnë ose ftohen në dëgjim publik.

Kryetari - Sqaroi se do të mbahet një dëgjim i përbashkët, ku do të diskutohen procedurat ligjore ndërkombëtare, çështjen e dëshmitarëve, aktgjykimeve dhe çështje të tjera, duke e përmbyllur kështu një detyrim, të cilin e kemi marrë nga Plani i veprimit. Ndërsa çështja e raportimeve do të bëhen me radhë, ku do të ftohen secila nga ministritë dhe agjencitë në takime të veçanta.

Armend Zemaj - U pajtua me parafolësit dhe shtoi se në ftesë që do t'ju dërgohet këtyre institucioneve, të ceket se për çka është ftuar dhe cilat çështje do të debatohen, në mënyrë që të jenë të njoftuar paraprakisht.

Kryetari konstatoi se Komisioni në mënyrë unanime nxori këtë:

P e r f u n d i m

Komisioni vendosi të mbajë dëgjim publik më 30 .04. 2010, në orën 11: 00

Të ndryshme

a. Shqyrtimi i Mocionit të deputetit Naim Rrustemi

Komisioni vendosi që kjo pikë të shtyhet për mbledhjen e radhës dhe të vihet si pikë e rendit të ditës.

Mbledhja përfundoi në orën 15: 30

Përgatiti:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit

Kryetari i Komisionit

Bahri Hyseni

